

AKT - THEMELIMI

“RAMA MINERAL” SH.P.K. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Themelimi, Themeluesit, Emri

Sot më datë 19.11.2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “RAMA MINERAL” sh.p.k.

Themeluesit e shoqërisë “RAMA MINERAL” sh.p.k., janë:

- **Rame Koxherri**, atësia Maksut, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër personal identifikimi I70724008N i datëlindjes 24.07.1987, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

Punime nëntokësore, punime minerare mbitokësore dhe karriera. Nxjerrje, përpunim dhe tregëtim minerale të ndryshme metalore dhe jometalore. Grumbullim, përpunim e tregëtim të Mineraleve të ndryshme. Transport, magazinim dhe përpunim të mineraleve të ndryshme. Përdorim të lëndëve plasëse për përdorim civil. Hapje dhe ndërtim rrugësh. Ndërtime të ndryshme infrastrukturore.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:

- Pasuria nr.14/302-ND, Vol.37, Fq.63, Z.K. 8190, Tiranë.

Kreu II

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar



Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 97,700 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë.

- Ortaku themelues **z.Rame Koxherri**, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 97,700 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kreu III

Administratori i shoqërisë

Neni 6

Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare, në pajtim me parashikimet e ligjit 9901 dt.14.04.2008, i ndryshuar. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare do të jetë *z. Rame Koxherri*, atësia Maksut, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër personal identifikimi I70724008N i datëlindjes 24.07.1987, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Kreu IV

Dispozitat Përfundimtare

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ortakët e shoqërisë nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Tiranës.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku do të jetë përcaktuar dhe emërtimi tregtar.

Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723 dt.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar.

Tiranë më 19.11.2024

THEMELUESIT

Rame KOXHERRI

